

zonja, "Dhe kam frikë se mos më mbesin pa shkollë. Të madhin djalë e kam n' Internatin e "Orshit".

Passi hëngërm bukë dhe pimë kafe, ramë të flemë. Mua, me qënë se s' kisha shtrojë më vete, më dhanë shiresë e mbulesa të mira.

Edhe në këtë shtëpi u ngriamë që në mëngjes dhe bëmë gati teshat. Zonja na bën nga një kafe, e pimë, dhe pastaj u nismë q' andej dyke falenderuar gruan e mirë.

Kjo zonjë ka patur një histori interesante të cilën e mësova më von. Besoj se do t'a interesoj lëçitësin në qoftë se ja tregoj këtu këtë rëfenjë.

Zef Noçi na ish martuar një herë, mirpo nuk bënte fëmijë. Pra, vendosi të marë dhe një grua të dytë — zonja në fjalë — me gjithë që e dinte se kisha do mos i vinte kurorë. Pa e rëmbetur këtë zonjë edhe e shpuri në shtëpi të tij, ku nuk e nxirte përjashta se mos e shanin bota; e mbante pa kurorë tok me gruan e parë.

Kjo punë vazhdoi mjaft kohë dhe një ditë na thëret priftin edhe i tregon të gjitha. I lutet priftit që të konsiderojë martesën të ligjshme, me qënë se kish bërë edhe një djalë me 'të. Prifti i shkroj Papës(?) dhe Papa jo vetëm që nuk e pranoi këtë punë po edhe dha urdhër që të ekskomunikojnë Noçin. Ekskomunikimi u bë